



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbajtur, më 06.03.2020)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:38 dhe mbaroi në orën 10:39.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i> |
| <i>2. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>10. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>11. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
- 5. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 6. Anisa Brano, Këshilltare e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 7. Denisa Varfi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 8. Anisa Kuçi, EURALIUS.*
- 9. Erion Fejzulla, USAID.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi gjyqtarët e caktuar në çështje gjyqësore të veçanta në ish-gjykatat për krimet e rënda, sot gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar”.
2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për disa shtesa në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30 date 14.02.2019”.

Mbledhja plenare e datës 6 mars 2020 fillon me prezantimin e 2 pikave të rendit të ditës nga Kryetarja së Këshillit, zonja Naureda Llagami.

Relatore e këtyre 2 çështjeve është zonja Marçela Shehu.

Merr fjalën zonja Marçela Shehu e cila lexon relacionin shpjegues nr. 1608 prot., datë 06.03.2020 lidhur me përmbajtjen e 2 projektvendimeve: “Mbi gjyqtarët e caktuar në çështje gjyqësore të veçanta në ish-gjykatat për krimet e rënda, sot gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar” dhe “Për disa shtesa në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 14.02.2019”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, me fillimin e funksionimit të gjykatave të

posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar më datë 19.12.2019, këto të fundit i kanë kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor të shprehet për statusin e gjyqtarëve të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, të caktuar më herët nga Këshilli, pranë gjykatave për krimet e rënda, për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore, të cilat tashmë ndodhen për shqyrtim përpara tyre, pra nëse ata gjyqtarë do të vijonin të gjykonin këto çështje.

Marrë shkas nga kjo problematikë, Këshilli i Lartë Gjyqësor i ka dërguar shkresë Ministrisë së Drejtësisë, ku ndër të tjera i ka adresuar disa problematika lidhur me periudhën tranzitore të transformimit të gjykatave për krimet e rënda në gjykata të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, sikundër dhe për periudhën në vijim në situatën e qenies jo funksionale të skemës së delegimit dhe pazbatueshmërisë së transferimit të përkohshëm. Ende sot, që nga data 19.12.2019, nuk ka vijuar më tej gjykimi i 9 çështjeve gjyqësore, në pritje të një vendimi nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Prandaj, si organi kushtetues përgjegjës për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, KLGJ duhet të vendosë përfundimisht, nëse gjyqtarët e gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, të caktuar më herët nga Këshilli, pranë gjykatave për krimet e rënda, për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore, do të vijnë të gjykojnë këto çështje në themel.

Lidhur me këtë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pasi bën një analizë të thelluar të konceptit të “gjyqtarit natyral”, trajtuar gjerësisht në Vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 13, datë 04.04.2018, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor projektvendimin “Mbi gjyqtarët e caktuar në çështje gjyqësore të veçanta në ish-gjykatat për krimet e rënda, sot gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i cili i jep zgjidhje situatës së parë, gjykimit të këtyre 9 çështjeve që për shkak të ligjit janë transferuar në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, pra ata gjyqtarë të vazhdojnë të shqyrtojnë në themel këto 9 çështje të regjistruara në ish-gjykatat për krimet e rënda.

Ndërkohë, projektvendimi tjetër, ai “Për disa shtesa në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.30, datë 14.02.2020”, synon zgjidhjen e situatës së dytë, asaj të nevojave në vijim, në çështje gjyqësore të veçanta, në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar. Lidhur me këtë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor shtimin e Kreut X/2 në vendimin nr. 30, datë 14.02.2020 të titulluar “Dispozitë për gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe

krimin e organizuar”.

Anëtarët e Këshillit për çështjen e parë të rendit të ditës nuk kanë diskutime, prandaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës mbi projektvendimin e parë “Mbi gjyqtarët e caktuar në çështje gjyqësore të veçanta në ish-gjykatat për krimet e rënda, sot gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, vendosi:

“I. Gjyqtarët e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në ish-gjykatat për krimet e rënda, vazhdojnë të shqyrtojnë në themel këto çështje të regjistruara përpara gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, si më poshtë:

1. Gjyqtarët Erjon Bani dhe Ardian Kalia, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen penale kundër të pandehurit {...}, i akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 284/1, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal, regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda).

2. Gjyqtarët Shefkije Demiraj dhe Kreshnik Omari, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen penale kundër të pandehurit {...}, i akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 333/a, paragrafi i parë, 283/a, paragrafi i parë dhe 334, paragrafi i parë, të Kodit Penal, regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda).

3. Gjyqtari Erjon Bani, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen penale kundër të pandehurit {...}, i akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a/1-22, 28/4, 333/a/2, 334/1, 278/2 dhe 280 të Kodit Penal, regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda).

4. Gjyqtarët Ardian Kalia, Erjon Bani dhe Artan Gjermëni, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen penale kundër të pandehurve {...} dhe {...}, të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal, regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda).

5. Gjyqtari Ardian Kalia, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen penale kundër të pandehurve Moisi Habilaj, etj., të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a/1-22, 28/4, 333/a/2, 334/1, 278/2 dhe 280 të Kodit Penal, regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda).

6. Gjyqtari Sokol Tona, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në çështjen penale kundër të pandehurit Besnik Spaho, i akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 79/c i Kodit Penal, regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda).

7. Gjyqtarët Etleva Temo dhe Artur Kalaja, respektivisht të Gjykatës së Apelit Korçë dhe të Gjykatës së Apelit Tiranë, në çështjen penale kundër të pandehurve {...} etj., të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 109/b/1 dhe 28/4, 238 dhe 28/4, 152/1, 333/a/1 dhe 334/1 të Kodit Penal, regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Apelit për Krimet e

Rënda).

8. Gjyqtarët Genti Shala, Valdete Hoxha dhe Asim Vokshi, të Gjykatës së Apelit Tiranë, në çështjen penale kundër të pandehurit {...}, i akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 109/b/1, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal, regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda).

9. Gjyqtarët Genti Shala dhe Valdete Hoxha, të Gjykatës së Apelit Tiranë, në çështjen penale kundër të pandehurit {...}, i akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a/2 dhe 333/a/2 të Kodit Penal, regjistruar përpara Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (ish-Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda).

II. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarëve dhe gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen e dytë

Merr fjalën zonja **Brunilda Kadi** e cila pas arsytimit të saj propozon që gjyqtarët që caktohen në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të përzgjidhen me short nga gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, pra jo vetëm nga gjykatat e apelit, pasi sipas mendimit të saj këtë kriter, të vendosur në pikën 3 të projektvendimit, e plotësojnë shumë pak gjyqtarë nga lista që e kanë kaluar vetingun.

Hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i bërë nga zonja Kadi për të ndryshuar pikën 3 të projektvendimit, ku të shtohen edhe gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është kundër.

Iilir Toska është kundër.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është kundër.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është kundër, me arsyetimin se po bëhet një shtesë në vendimin e miratuar më parë nga Këshilli në të cilin caktimi i gjyqtarit do bëhej nga gjyqtarët e të njëjtit nivel me gjykatën ku gjyqtari do të caktohej. Edhe në rastin e Gjykatës së Lartë u mbajt i njëjti qëndrim. Prandaj zonja Ukperaj është e mendimit që i njëjti standard dhe qëndrim të mbahet edhe për Gjykatën e Posaçme të Apelit.

Medi Bici është pro.

Naureda Llagami është kundër.

(6 anëtarë janë pro propozimit të zonjës Kadi. Pranohet propozimi i zonjës Kadi për të shtuar edhe gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë në pikën 3 të projektvendimit.)

Hidhet më pas në votim propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës bashkë me ndryshimin në pikën 3 të projektvendimit, të miratuar pak më lart nga shumica, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord në tërësi, por kundër ndryshimit të pikës 3.

Illir Toska është dakord, por kundër shtesës që u bë nga shumica e votave të anëtarëve.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord, përveç ndryshimit të pikës 3.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord, me përjashtim të pikës që votoi kundër. Zonja Ukperaj mendon që kjo kërkon reflektim edhe në pikën 4 të rregullores.

Medi Bici është kundër.

Naureda Llagami është dakord, përveç pikës 3.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, me ndryshimin e pikës 3 të miratuar nga shumica e votave të

anëtarëve, vendosi miratimin e projektvendimit si më poshtë:

“Në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, bëhen këto shtesa:

Pas paragrafit X/1, shtohet paragrafi X/2 me këtë përmbajtje:

“X/2 Dispozitë për gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar

1. Ky vendim zbatohet edhe për gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar.

2. Gjyqtarët që caktohen në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për çështje gjyqësore të veçanta, përzgjidhen, me short, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, të cilët kanë të paktën 7 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën 5 vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Gjyqtarët që caktohen në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për çështje gjyqësore të veçanta, përzgjidhen, me short, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit me juridiksion të përgjithshëm, të cilët kanë të paktën 10 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën 5 vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.”

Pas miratimit të projektvendimit të sipërcituar, merr fjalën **zonja Kadi** për të bërë një sqarim mbi atë çka propozoi zonja Ukperaj, atë të reflektimit në rregullore edhe të një ndryshimi tjetër ku bëhet fjalë për Gjykatën e Lartë.

Zonja Ukperaj merr fjalën për të sqaruar faktin që reflektimi ishte për parimet e përgjithshme, kur Këshilli ka pranuar që do të çojë gjyqtarë të të njëjtit nivel.

Rimerr fjalën **zonja Kadi** e cila shton se në Gjykatën e Lartë gjyqtarët janë marrë

nga apeli dhe janë dërguar në Gjykatën e Lartë. Pra s'do ketë nevojë për reflektim.

Zoti Toska merr fjalën për ta përmbyllur diskutimin, duke shtuar se kjo dispozitë e posaçme është vetëm për Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe nuk ka nevojë për reflektime.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor